

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8277  
E enjte, 9 prill 2026  
Çmimi 0.50 €

**PDK-ja i dërgon letër  
zyrtare Albulena  
Haxhiut për anëtarin  
e dytë në KQZ** | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## MË SHUMË GJASA PËR PRESIDENT APO PËR ZGJEDHJE?

 | FAQE 4-5

Gjasat ekzistojnë, por ato janë të kufizuara. Kështu i komentojnë mundësitë për arritjen e një marrëveshjeje politike për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës përfaqësuesit e shoqërisë

civile, Mexhide Demolli nga "Lëvizja Fol" dhe Emir Abrashi nga "Demokraci Plus". Ata vlerësojnë se një figurë jopolitike mund të sigurojë konsensus, pasi presidenti, sipas

Kushtetutës, përcaktohet si "simbol i unitetit kombëtar". Nëse nuk arrihet marrëveshje, Kosova do të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh

### AKTUALE



**BYROJA PËR VERIFIKIMIN E  
PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME,  
KDI-JA THOTË SE LIGJI KA  
HAPËSIRA TË PASIGURTA  
JURIDIKE** F. 5

**PËRCILLET PËR VOTIM NË  
KUVEND PROJEKTILIGJI PËR  
MATURËN SHETËTËRORE** F. 7

**ROMANI DOKUMENTAR "REVOLTA  
E SIZIFIT" I AUTORIT BARDHYL  
MAHMUTI PËRURORHET  
MË 17 PRILL NË DRENAS,  
MË 18 PRILL NË PRISHTINË** F. 6

### EKONOMI



**ARMËPUSHIMI SHBA-IRAN,  
KUSARI-LILA: PRITET STABILIZIMI  
I ÇMIMIT TË NAFTËS** F. 6

**NDALOHEM PUNONJËS TË  
POSTËS SË SERBISË NË VERI TË  
KOSOVËS PËR "SHPËRNDARJE TË  
PALIGJSHME" TË DËRGESAVE** F. 8

### SPORT

**MINISTRIA E SPORTIT DHE  
FEDERATAT NËNSHKRUAJNË  
MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË  
VLERË PREJ 6.5 MILIONË EUROSH**

F. 11



**BOTA REAGON PAS  
ARMËPUSHIMIT  
MES SHTETEVE  
TË BASHKUARA  
DHE IRANIT** F. 2



**AIP PARAQET RAPORTIN  
2025 NË KUVEND:  
MBI 1 MIJË ANKESA DHE  
367 INSPEKTIME PËR  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE** F. 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
[info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# BOTA REAGON PAS ARMËPUSHIMIT MES SHTETEVE TË BASHKUARA DHE IRANIT

Presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar se ShBA-ja ka pranuar një armëpushim dyjavor me Iranin, të ndërmjetësuar nga Pakistani, për t'u dhënë kohë palëve që të negociojnë një marrëveshje paqeje

WASHINGTON, 8 PRILL - Shtetet e Bashkuara dhe Irani janë pajtuar të mërkurën për një armëpushim dyjavor nën ndërmjetësimin e Pakistanit.

Presidenti amerikan Donald Trump tha se ShBA-ja ka pranuar një armëpushim dyjavor me Iranin, të ndërmjetësuar nga Pakistani, për t'u dhënë kohë palëve që të negociojnë një marrëveshje paqeje.

Trump, i cili më 7 prill paralajmëroi se "një qytetërim i tërë do të vdesë sonte" nëse Irani nuk bën marrëveshje, tha se ka marrë nga Teherani një propozim me 10 pika dhe se e konsideron atë një bazë të mirë për negociatë.

Agjencia e lajmeve Tasnim, e afërt me forcat e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC), konfirmoi se është "vendosur" një armëpushim midis dy palëve, "me kushte të caktuara".

Trump, gjithashtu, nuk dha detaje për propozimin iranian, por tha se marrëveshja varet nga lejimi i lëvizjes së lirë të anijeve në Ngushticën e Hormuzit - një rrugë shumë e rëndësishme për transportin e naftës dhe gazit. "... pas kërkesës së tyre që unë t'i ndalja sulmet shkatërruese që ishin planifikuar për sonte ndaj Iranit, dhe me kusht që Republika Islamike e Iranit të pajtohet për hapjen e plotë, të menjëhershme dhe të sigurt të Ngushticës së Hormuzit, unë pranoj t'i pezulloj bombardimet dhe sulmet ndaj Iranit për një periudhë dyjavore", shkroi Trump në rrjetet sociale.

Analistët e përshkruajnë këtë kusht si çelës të marrëveshjes, duke shtuar se stabiliteti i armëpushimit do të varet nga Teherani.

Ajo nuk dha detaje shtesë, duke thënë se ato do të shpallen së shpejti.

Gjatë kësaj kohe, palët pritet të zhvillojnë bisedime për një marrëveshje për paqe të përhershme.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e përshëndeti armëpushimin dyjavor midis Shteteve të Bashkuara dhe Iran, duke thënë se ai do t'i ulë tensionet. "E mirëpres armëpushimin dyjavor për të cilin ShBA-ja dhe Irani u pajtuan mbrëmë. Ai sjell uljen e tensioneve, që është shumë e nevojshme" tha ajo, duke shtuar se është thelbësore që negociatat të vazhdojnë për një zgjidhje të qëndrueshme.

Kancelari i Gjermanisë, Friedrich Merz, gjithashtu e përshëndeti armëpushimin në luftën në Lindjen e Mesme dhe bëri thirrje për një përfundim përfundimtar të konfliktit. Qëllimi tani është "të negociohet një fund i qëndrueshëm i luftës në ditët në vijim", tha ai në një deklaratë. "Kjo mund të arrihet vetëm përmes diplomacisë".

Ai shtoi se Gjermania do të kontribuojë "për të garantuar lirinë e lundrimit në Ngushticën e Hormuzit".

Presidenti francez, Emmanuel Macron, e përshëndeti armëpushimin, duke e quajtur marrëveshjen "gjë shumë e mirë". "Presim që në ditët dhe javët në vijim ajo të respektohet plotësisht në të gjithë rajonin dhe të lejojë zhvillimin e negociatave", tha Macron në fillim të një takimi të zyrtarëve të lartë të mbrojtjes dhe sigurisë. "Dëshira jonë është të sigurohemi që armëpushimi të përfshijë plotësisht edhe Libanin", shtoi ai.

Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Keir Starmer, ka udhëtuar drejt Gjirit për të zhvilluar bisedime me liderët rajonalë, në përpjekje për t'u



siguruar që Ngushtica e Hormuzit të hapet përgjithmonë pas armëpushimit mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, njoftoi zyra e tij. "E mirëpres marrëveshjen e armëpushimit të arritur gjatë natës, e cila do të sjellë një moment lehtësimi për rajonin dhe botën", tha Starmer në një deklaratë. "Së bashku me partnerët tanë duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për ta mbështetur dhe ruajtur këtë armëpushim, për ta kthyer atë në një marrëveshje afatgjatë dhe për ta rihapur Ngushticën e Hormuzit", shtoi ai. Spanja thotë se njerëzimi iu

afrua katastrofës me ultimatumit të Trump ndaj Iranit

Bota iu afrua "rrezikshëm shumë" një katastrofe pasi presidenti amerikan, Donald Trump, kërcënoi të shkatërronte qytetërimin iranian në ultimatumit e tij ndaj Teheranit, tha ministri i Jashtëm i Spanjës, Jose Manuel Albares, pas shpalljes së armëpushimit.

Ai i tha radios RNE se ultimatumit i Trump ishte "absolutisht i papranueshëm për njerëzimin" dhe se është shumë herët për të përcaktuar nëse konflikti ka përfunduar përfundimisht. "Kur lideri i një superfuqie ushtarake bën kërcënime të tilla, unë i marr seriozisht", shtoi ai.

Kina tha se e mirëpret armëpushimin midis ShBA-së dhe Iranit. "Kina mirëpret që palët përkatëse njoftuan arritjen e një marrëveshjeje për armëpushim", tha zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtëm, Mao Ning, duke shtuar se Kina do të vazhdojë të punojë për rikthimin e paqes në Lindjen e Mesme.

Egjipti, i cili javët e fundit ka ndihmuar në ndërmjetësimin e mesazheve midis SHBA-së dhe Iranit, e mirëpriti njoftimin e presidentit amerikan Donald Trump për armëpushim dyjavor. Në një telefonatë gjatë natës me të dërguarin amerikan Steve Witkoff, ministri i Jashtëm egjiptian, Badr Abdelatty, "shprehu vlerësimin e tij të thellë

për këtë hap të rëndësishëm amerikan për t'i dhënë një shans diplomacisë dhe për të nisur një proces serioz negociatash amerikano-iraniene".

Ministria e Jashtëm tha se armëpushimi është një "mundësi thelbësore që duhet shfrytëzuar për të hapur rrugën për negociatë" dhe theksoi se Egjipti është i përkushtuar të "vazhdojë përpjekjet e palodhura" së bashku me Pakistanin dhe Turqinë.

Një zyrtar i lartë i Emirateve të Bashkuara Arabe tha se vendi i tij ka dalë fitues nga lufta ShBA-Iran pas shpalljes së një armëpushimi dyjavor. "Emiratet e Bashkuara Arabe dolën fituese nga një luftë që sinjerisht kërkuam ta shmangnim", tha këshilltari presidencial Anëar Gargash në një postim në X. "Sot jemi të përgatitur të lundrojmë në një peizazh të koklavitur rajonal me më shumë burime, një kuptim më të thellë dhe një kapacitet më të fortë për të ndikuar dhe formësuar të ardhmen", shtoi ai.

Turqia bëri thirrje që të gjitha palët ta respektojnë armëpushimin e arritur midis ShBA-së dhe Iranit. "Ne këmbëngulim që armëpushimi i përkohshëm të zbatohet plotësisht në terren dhe shpresojmë që të gjitha palët t'i përmbahen marrëveshjes", tha Ministria e Jashtëm në një deklaratë.



# ZEMAJ KËRKON SQARIME NGA MINISTRI HOTI PËR EKSPOZITËN 'MASAKRAT NË KOSOVË 1998 - 1999'

PRISHTINË, 8 PRILL - Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka kërkuar sqarime nga ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, lidhur me ekspozitën "Masakrat në Kosovë 1998 - 1999", për të cilën ai tha se ka përmbajtur pasaktësi si rezultat i interpretimit të gabuar të të dhënave.

Zemaj theksoi rëndësinë e kësaj ekspozite, duke ngritur shqetësime për përmbajtjen e saj dhe përputhshmërinë me të vërtetën historike, ndërsa kërkoi edhe sqarime për financimin dhe shpërndarjen e materialeve të lidhura me të. "Për rëndësinë e kësaj ekspozite, për pjesët e Ushtisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe deklaratat që kanë dalë nga protagonistët e këtyre ngjarjeve, nuk rezultojnë me të vërtetën historike. Është një devijim që konsiderohet i qëllimshëm ose i paqëllimshëm, por që duhet të vërtetohet në aspektin institucional, pra edhe kjo pjesë e përgjegjësisë ju takon edhe juve si kategori e re institucionale për mbrojtjen e vlerave të luftës çlirimtare. Shohim cili ka qenë financimi i shtetit edhe për këtë ekspozitë ose librat të cilat tash përfolën,

ndër librat që ekziston pjesa faktike financimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku është shpërndarë, kush i ka shpërndarë, cili ka qenë qëllimi, a ka pasoja nga këto devijime historike të cilat janë të dëmshme, të cilat kanë të bëjnë me ngjarjet tragjike të luftës, ku flitet për masakra, evidentimin e numrit të njerëzve, familjarëve edhe diçka që lidhet që është temë edhe sensitive, por është në fund të fundit çmimi që ka paguar populli shqiptar për liri dhe pavarësi, sidomos në fundit e fundit", pyeti Zemaj.

Ministri Andin Hoti tha se është krijuar një perceptim i gabuar publik për përgjegjësinë e ministrisë që ai drejton lidhur me këtë ekspozitë, duke theksuar ndarjen e qartë të kompetencave institucionale në Kosovë. "Ajo çka ka ndodhur, dy javët e fundit, në veçanti ajo ngjarje në Prishtinë, pa dashur të hyj në debat politik këtu, krijimi i një opinionit publik se qenka ministria që unë udhëheq, pavarësisht emërimit që e ka, dhe tash po jua shpjegoj pse ka një lloj përgjegjësie në raport me atë çka ka ndodhur në ekspozitën në



shesh. Në Republikën e Kosovës mekanizmat, institucionet janë të ndara në fushëveprimtrinë e tyre. Rrjedhimisht, mekanizmi ose institucioni, instituti, që bën përmbledhjen e historisë nuk jam unë, është Instituti i Historisë. Institucioni që bën verifikimin e fakteve është Instituti për Krimet e Luftës, që

është themeluar para dy tre vjetësh. Ministria ka për mandat reagimin, mbrojtjen e vlerave dhe reagimin. Dhe çka kam bërë unë është, nuk po them që jam i pari, por ndër të parët që kam reaguar për ekspozitën", tha ai. Pas kësaj, deputeti Armend Zemaj reagoi sërish duke

kërkuar sqarime shtesë, ndërsa kryetarja e Komisionit, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, e akuzoi atë për politizim të çështjes. Ndërkohë ministri Andin Hoti shtoi se iniciatori i ekspozitës, Shkëlzen Gashi, nuk është kryeministri Albin Kurti, por bëhet fjalë për një iniciativë individuale të autorit. (EO)

## DEPUTETI I PDK-SË KËRKON NGA INSTITUCIONET QË GJYKIMI I KRERËVE TË UÇK-SË TË JETË PRIORITYET

PRISHTINË, 8 PRILL - Deputeti i PDK-së, Artan Behrami, ka kërkuar nga ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, që çështja e gjyqimit të krerëve të UÇK-së në Hagë të jetë prioritet numër një i angazhimit institucional.

Behrami ka theksuar se raportimi për Dhomat e Specializuara duhet të ndryshojë dhe të bëhet drejtpërdrejt në Kuvendin e Kosovës, duke kërkuar edhe ndryshime ligjore nëse është e nevojshme. "Do të fokusohem vetëm në Dhomat e Specializuara të Kosovës, sa i takon raportimit kjo gjykatë edhe më tutje i raporton



UNMIK-ut përmes EULEX-it, kështu e bën këtë gjykatë jo të Kosovës por të Kombeve të Bashkuara, është mirë që të bashkërendohen veprimet në mënyrë që ky raportim të bëhet

në Kuvendin e Kosovës, nëse dikush thotë që nuk është në ligj, duhet të ndryshohet edhe ligji. Një angazhim i cili duhet të ketë prioritet numër një në këtë fazë verdikti për krerët e

UÇK-së në Hagë. Mendoj se angazhimi juaj në këtë drejtim do të mundësonte që ky verdikt të mos bazohet në vendime politike, por në sallë të gjyqit", ka thënë Behrami.

Ai ka kërkuar nga ministri Hoti që të ketë angazhim konkret për përmbushjen e kërkesave të ish-krerëve të UÇK-së. "Ju kisha lutur si ministër i ri, në mënyrë që kërkesat që kanë ardhur në këtë fazë nga krerët e UÇK-së të plotësohen", ka thënë Murati, duke e pyetur ministrin Hoti se cili do të jetë angazhimi i tij konkret për këta muaj.

Ndërkaq ministri Andin Hoti ka thënë se beson që procesi në Dhomat e Specializuara do të

përfundojë shpejt dhe se të akuzuarit, sipas tij, do të dalin të lirë. "Dhomat e Specializuara kanë për të përfunduar shumë shpejt dhe të gjithë ata që janë padrejtësisht në Hagë do të dalin të lirë. Çfarëdo që është në kompetencë të ministrisë që drejtoj, natyrisht se do të jetë në dispozicion të secilit për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së. Por, departamenti që merret me Dhomat e Specializuara është në Ministrinë e Drejtësisë, nuk është tek unë. Megjithatë po e përsëris, në kompetencën time, në bashkëpunim me cilindo departament, natyrisht që do të jemi të gatshëm të ofrojmë shërbimet tona si ministri", ka thënë Hoti.

## Çështja e presidentit, Mustafa: Duhet të ketë hapësirë për marrëveshje

PRISHTINË, 8 PRILL - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka folur për çështjen e zgjedhjes së presidentit të vendit. Ai ka thënë se nëse dëshirohet që kjo çështje të marrë një zgjidhje, duhet të ketë hapësirë për marrëveshje, raporton Ekonomia Online. "Në qoftë se dëshirojmë zgjidhje, duhet të jemi të gatshëm si pozitë dhe opozitë ta zgjedhim presidentin, pra të ketë hapësirë për marrëveshje. Domethënë, duhet të ulen

pozita dhe opozita, të merren vesh bashkërisht për një personalitet", tha ai.

Ndërsa i pyetur nëse do të kthehet Vjosa Osmani në Lidhjen Demokratike të Kosovës, Mustafa nuk dëshiroi të flasë për këtë, duke thënë se nuk është ky rasti që të flasë për këtë temë. "Do t'ju kërkoj falje, sepse sot është krejt një temë tjetër. Nuk do të dëshiroja që sot këtë çështje që e kemi hapur këtu në Akademi ta ndërlihd me emra konkretë,

kush synon e kush çka ka bërë të mbarën. Mund ta shfrytëzojmë ndonjë rast tjetër që unë të jap qëndrimin tim politik", tha ai.

Sa i përket mungesës së Abdixhikut në promovimin e librit, Mustafa tha se kush ka pasur dëshirë ka ardhur. "Për ftesat e këtij libri ne kemi pasur atje përpara ftesë publike, kështu që kanë ardhur ata që kanë dashur të vijnë, me të cilët ne kemi punuar një kohë të gjatë", tha Mustafa.





# MË SHUMË GJASA PËR PRESIDENT APO PËR ZGJEDHJE?

Gjasat ekzistojnë, por ato janë të kufizuara. Kështu i komentojnë mundësitë për arritjen e një marrëveshjeje politike për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës përfaqësuesit e shoqërisë civile, Mexhide Demolli nga “Lëvizja Fol” dhe Emir Abrashi nga “Demokraci Plus”. Ata vlerësojnë se një figurë jopolitike mund të sigurojë konsensus, pasi presidenti, sipas Kushtetutës, përcaktohet si “simbol i unitetit kombëtar”. Nëse nuk arrihet marrëveshje, Kosova do të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh

**PRISHTINË, 8 PRILL** - Gjasat ekzistojnë, por ato janë të kufizuara. Kështu i komentojnë mundësitë për arritjen e një marrëveshjeje politike për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës përfaqësuesit e shoqërisë civile, Mexhide Demolli nga “Lëvizja Fol” dhe Emir Abrashi nga “Demokraci Plus”.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, udhëheqës i Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, zhvilloi këtë javë një takim me udhëheqësin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, dhe paralajmëroi bisedime edhe me udhëheqësin e Partisë Demokratike të Kosovës.

Kurti dhe Abdixhiku deklaruan pas takimit se nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje, por thanë se do t'i vazhdojnë bisedimet për t'i shmangur zgjedhjet e reja

parlamentare.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi Zyrën e kryeministrit Kurti për të pyetur se çfarë pritjesh ka nga këto bisedime dhe nëse zgjidhja politike është në horizont, por nuk mori përgjigje.

Zëdhënësi i Partisë Demokratike të Kosovës, Faton Abdullahu, konfirmon për Radion Evropa e Lirë se kreu i kësaj partie më të madhe opozitare, Bedri Hamza, do t'i përgjigjet ftesës së Kurtit kur të specifikohet propozimi, përkatësisht kur të jetë e qartë se çfarë do të diskutohet. “Ky konkretizim do të na ndihmonte që ne ta shqyrtonim atë në organet tona më të larta, për shembull në Këshillin Drejtues të PDK-së, dhe pastaj, pas shqyrtimit, të dalim me përgjigje konkrete”, thotë Abdullahu.

Kurti duhet ta sigurojë

mbështetjen më të gjerë të anëtarëve të Kuvendit të Kosovës deri më 28 prill - afat i caktuar nga Gjykata Kushtetuese për zgjedhjen e presidentit.

Nëse nuk arrihet marrëveshje, Kosova do të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Mandati i presidentes Vjosa Osmani skadoi më 4 prill dhe pozitën e ushtrueses së detyrës së presidentes e mori kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, ashtu siç përcaktohet në Kushtetutën e Kosovës.

## Çfarë thonë shifrat?

Sipas Kushtetutës së Kosovës, kandidati për president duhet të sigurojë dy të tretat e votave në Kuvendin me 120 deputetë - pra të paktën 80 vota.

Nëse në dy rundet e para asnjë kandidat nuk i merr votat e nevojshme, në rundin e tretë mjafton shumica e thjeshtë - prej së paku 61 votash - me kusht që në sallë të jenë të pranishëm të paktën 80 deputetë.

Lëvizja Vetëvendosje ka 57 mandate dhe e ka formuar Qeverinë me mbështetjen e nëntë deputetëve nga komunitetet joshumicë.

Partia Demokratike e Kosovës ka 22 ulëse në Kuvend, Lidhja Demokratike e Kosovës 15, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 6.

Kurti ka thënë më herët se synon të sigurojë më shumë se 80 vota, në mënyrë që zgjedhja e presidentit të jetë e garantuar.

## Cilat janë gjasat për marrëveshje?

Demolli thotë se të gjitha partitë politike kanë shprehur dëshirë për t'i shmangur zgjedhjet e reja dhe se takimi mes Kurtit dhe Abdixhikut ka lënë hapësirë për vazhdimin e negociatave.

Megjithatë, ajo nënvizon se për arritjen e një konsensusi, duhet të plotësohen disa kushte: Lëvizja Vetëvendosje të pranojë një

kandidat jopartiak, PDK-ja ose AAK-ja të mos i bojkotojnë seancat dhe të sigurojnë kuorumin, ndërsa LDK-ja me 15 deputetët e saj të luajë rolin e “urës” mes palëve. “Gjasat që këto tri kushte të përmbushen brenda tri javësh, janë të vogla, por jo të pamundura, sidomos nëse ka presion të jashtëm, veçanërisht nga partnerët ndërkombëtarë si BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara”, thotë Demolli.

Abrashi vlerëson se nuk ka pasur negociata serioze me PDK-në dhe AAK-në, ndërsa bisedimet me LDK-në nuk kanë sjellë rezultate konkrete. “Nëse kjo situatë vazhdon, ka shumë gjasa që afati të skadojë pa zgjidhje, dhe më pas të pasojë një tjetër manovër politike me zhvendosje të përgjegjësisë tek opozita”, thotë Abrashi.

Ai shton se Lëvizja Vetëvendosje, si partia më e madhe në Kuvend, duhet ta lehtësojë arritjen e konsensusit. “Kjo mund të nënkuptojë pranimin e disa kërkesave të opozitës për të shmangur zgjedhjet e parakohshme”, thotë Abrashi, duke shtuar se dështimi mund të tregojë mungesë vullneti real për zgjidhje ose përpjekje për të ruajtur kontrollin mbi postin e presidentit.

# BYROJA PËR VERIFIKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME, KDI-JA THOTË SE LIGJI KA HAPËSIRA TË PASIGURTA JURIDIKE



PRISHTINË, 8 PRILL - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka paralajmëruar se versioni aktual i Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme kërkon një

trajtim të kujdesshëm dhe adresim të çështjeve kyçe të ngritura nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe Komisioni i Venecias.

Në konferencën për medie KDI-ja theksoi se “forcimi i

mekanizmave për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme është një hap i domosdoshëm në luftën kundër korrupsionit”, por paralajmëroi se një reformë e tillë duhet të ndërtohet mbi “parime të qarta

kushtetuese, siguri juridike dhe respektim të të drejtave themelore”. Sipas KDI-së, versioni aktual i projektligjit nuk adreson plotësisht gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese (KO46/23) dhe

rekomandimet e Komisionit të Venecias, duke krijuar “hapësirë për paqartësi dhe rrezik për cenim të të drejtave kushtetuese”.

Në veçanti, Instituti ngriti shqetësime për: Vlefshmërinë kohore të verifikimit të pasurisë: përcaktimi që nga viti 2008 sipas KDI-së krijon pasiguri juridike dhe bie ndesh me standardet e Kushtetueses dhe kompetencat për nxjerrjen e legjislacionit sekondar: projektligji i jep Byrosë diskrecion të gjerë për të rregulluar procedura që prekin të drejtat pronësore, çështje që sipas KDI-së duhet të përcaktohen qartë në ligj.

KDI gjithashtu kritikoi mungesën e një procesi gjithëpërfshirës konsultimi publik, duke vënë në pikëpyetje transparencën dhe legjitimitetin e reformës.

Instituti ka dërguar letër me qëndrimet dhe rekomandimet e tij për të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe paralajmëroi se së shpejti do të publikojë një hulumtim parlamentar për këtë çështje.

KDI i bën thirrje Kuvendit që shqyrtimi i projektligjit të bëhet “me debat të hapur, gjithëpërfshirës dhe të bazuar në standarde kushtetuese dhe evropiane”, për të shmangur “zgjidhje që mund të rezultojnë të paqëndrueshme apo të kontestueshme në praktikë”.

## PDK-ja i dërgon letër zyrtare Albulena Haxhiut për anëtarin e dytë në KQZ

PRISHTINË, 8 PRILL - Partia Demokratike e Kosovës i është drejtuar edhe ushtrueses së detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, me një kërkesë zyrtare për procedimin e emërimit të anëtarit të dytë të kësaj partie në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në kërkesë theksohet se çështja e përbërjes së KQZ-së ka mbetur e papërfunduar gjatë mandatit të ish-presidentes Vjosa Osmani dhe se përfaqësimi i PDK-së

me dy anëtarë në këtë institucion nuk është çështje interpretimi politik, por një e drejtë që rrjedh nga dispozitat kushtetuese.

Në letrën e PDK-së gjithashtu theksohet rëndësia e respektimit të praktikës së deritanishme institucionale, sipas së cilës, PDK-ja ka qenë e përfaqësuar me dy anëtarë në KQZ, si dhe ruajtja e parimeve të barazisë dhe balancës mes subjekteve politike.

Duke iu referuar nenit 139,

paragrafi 4 të Kushtetutës së Kosovës, PDK-ja argumenton se shpërndarja e vendeve në KQZ duhet të bazohet në përfaqësimin e grupeve parlamentare në Kuvend. Në kushtet aktuale me katër grupe parlamentare, PDK-ja konsideron se secili grup duhet të ketë nga një përfaqësues në raundin e parë, ndërsa vendet e mbetura duhet të ndahen sipas madhësisë së grupeve, duke siguruar kështu përfaqësim proporcional.



### Kush mund të jetë kandidat kompromisi?

Abrashi vlerëson se një figurë jopolitike mund të sigurojë konsensus, pasi presidenti, sipas Kushtetutës, përcaktohet si “simbol i unitetit kombëtar”. Në këtë kontekst, ai shton se nevojitet një kandidat që garanton neutralitet institucional, stabilitet dhe besueshmëri. “Duke pasur parasysh polarizimin e thellë,

është e vështirë të imagjinohet që dikush nga elita ekzistuese politike, mund ta kryejë në mënyrë efektive këtë funksion. Rruga më reale është të zgjidhet një figurë me reputacion dhe jopartiake”, thotë Abrashi.

Më 5 mars, Lëvizja Vetëvendosje emëroi Glauk Konjufcën dhe Fatmire Kollçakun për pozitën e presidentit, por procesi nuk u përfundua për shkak të mungesës së kuorumit.

Një ditë më vonë, ish-presidentja Osmani nxori një dekret për shpërndarjen e

Kuvendit, por Gjykata Kushtetuese e anuloi atë me arsyetimin se nuk kishte efekt ligjor.

A po abuzohet me procesin e zgjedhjes së presidentit?

Demolli vlerëson se Lëvizja Vetëvendosje po përpiqet të paraqitet si parti konstruktive, por shton se në praktikë nuk ka përparim të mjaftueshëm drejt një zgjidhjeje.

Sipas saj, edhe opozita shpesh ka përdorur obstrukcionin, duke e bërë bojkotimin e seancave pothuajse reagim

rutinor - gjë që ka dëmtuar edhe kulturën parlamentare. “Në fund, kemi dy palë që pretendojnë se duan stabilitet, por secila e sheh atë përmes dominimit të vet. Kjo do të thotë se nuk është më vetëm një krizë kushtetuese, por një krizë me qëllim të përbashkët politik”, thotë Demolli.

Abrashi vlerëson se opozita është duke treguar gatishmëri për dialog, ndërsa qasja e Kurtit dhe Vetëvendosjes është më pak fleksibile. “Pritet që opozita të mbështesë kandidatin e

pushtetit, gjë që nuk është e qëndrueshme në një sistem parlamentar që kërkon bashkëpunim”, shpjegon ai.

Ai shton se Kurti, më herët, ka pasur mundësi për një marrëveshje më të gjerë, përfshirë rizgjedhjen e Vjosa Osmani, por se kjo nuk ka ndodhur.

Kryetarja e Kuvendit dhe ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, tha më 7 prill se është e gatshme të ndihmojë në procesin e zgjedhjes së presidentit.

## Maqedonci e Jashari takojnë Haxhiun, flasin për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse

PRISHTINË, 8 PRILL - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, së bashku me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Bashkim Jashari, zhvilluan

takim me u. d. presidenten e Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu.

Gjatë takimit u diskutua për përparimin e arritur në zhvillimin e kapaciteteve

mbrojtëse, sfidat aktuale të sigurisë si dhe për hapat e mëtejshëm drejt forcimit dhe avancimit strategjik të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Zhvillimi i mëtejshëm i

kapaciteteve mbrojtëse mbetet prioritet i përbashkët institucional dhe element thelbësor për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit të Republikës së Kosovës.



## ARMËPUSHIMI SHBA - IRAN, KUSARI-LILA: PRITET STABILIZIMI I ÇMIMIT TË NAFTËS

PRISHTINË, 8 PRILL - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, beson se stabilizimi i çmimit të naftës do të vazhdojë në ditët në vijim pas arritjes së marrëveshjes për armëpushim dyjavor mes ShBA-së dhe Iranit.

Kusari-Lila tha se mekanizimi ekzistues për përcaktim e çmimeve maksimale të lejuara të derivateve të naftës nuk do të lejojë të shkohet mbi normën e përcaktuar. "Uroj që stabilizimi i çmimit të naftës dhe derivateve të vazhdojë ditëve në vijim, dhe kjo do të varet nga rrethanat në Lindjen e Mesme. Është shumë e rëndësishme që mekanizmi ynë deri tani ka dhënë rezultatet

e veta, ndoshta jo në nivel 100%. Ne dy herë në ditë marrim informata mbi çmimin e importit të naftës dhe derivateve të saj, prandaj kemi mekanizmin e marzhës që nuk do të lejojë të shkohet mbi normën e përcaktuar të çmimit të naftës dhe derivateve", tha ajo.

Ministrja e Tregtisë, Kusari-Lila, tha se në situatën aktuale po shikojnë mundësitë e ndërhyrjes te sektori i transportit dhe i bujqësisë. "Aktualisht në situatën që jemi është siguruar që ka pasur mbarëvajtje sektori, por edhe nuk ka shkuar në ekstrem çmimi përkundër lëvizjeve që kanë ndodhur në berëzat ndërkombëtare. Jemi



duke e shikuar mundësinë e ndërhyrjes te sektori i transportit dhe i bujqësisë, ndërsa te sektorët që ende e

kanë mundësinë e operimit pa ndërprerje mbetet të shihet për një rrethanë tjetër", deklaroi ajo. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

dhe Irani janë pajtuar për një armëpushim dyjavor që mundëson edhe lëvizje nëpër Ngushticën e Hormuzit.

## RUDOLPH RIKONFIRMON GATISHMËRINË E GJERMANISË NË MBËSHTETJE TË KPK-së

PRISHTINË, 8 PRILL - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Arian Gashi, së bashku me anëtarin e Këshillit, Visar Krasniqi dhe Margarita Gjocaj, ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Rainer Rudolph.

Gjatë takimit kryesuesi Gashi e informoi ambasadorin Rudolph për zgjedhjen e tij në këtë detyrë si dhe për përbërjen e re të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ai theksoi se prioritetet kryesore të KPK-së mbeten rritja e transparencës dhe llogaridhënies, forcimi i integritetit institucional, si dhe avancimi i mëtejshëm i sistemit prokurorial në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Me këtë rast, kryesuesi Gashi shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë ndaj institucioneve të drejtësisë në Kosovë, në veçanti



ndaj sistemit prokurorial. Ai vlerësoi lart kontributin e Ambasadës së Gjermanisë përmes projekteve të realizuara në bashkëpunim me GIZ dhe IRZ, të cilat kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe forcimin e integritetit institucional të prokurorëve. Këto projekte kanë përfshirë trajnime të specializuara dhe mbështetje në fusha kyçe, si hetimet penale, luftimi i korrupsionit dhe krimet të organizuar, si dhe mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Nga ana e tij, ambasadori

Rudolph rikonfirmoi gatishmërinë e Ambasadës së Gjermanisë për ta vazhduar mbështetjen ndaj KPK-së dhe sistemit prokurorial në përgjithësi, duke theksuar rëndësinë e forcimit të sundimit të ligjit dhe të bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërinstitucional. Bashkëbiseduesit diskutuan gjithashtu për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në të ardhmen, me fokus në projekte konkrete që synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

## BASTISJE NË MITROVICË, SEKUESTROHEN ARMË DHE DROGË, ARRESTOHET I DYSHUARI

MITROVICË, 8 PRILL - Njësitë policore në Mitrovicë e Jugut kanë realizuar një bastisje në një shtëpi dhe objekte përcjellëse, duke sekuestruar armë dhe substanca të dyshuara narkotike. Sipas raportit të policisë, hetuesit policorë në kuadër të Stacionit Policor Jug në Mitrovicë, në mbështetje të Njësisë për Reagim të Shpejtë (NJRSh), mbi dyshime të bazuara për posedim ilegal të armëve, kanë realizuar këtë bastisje. Si rezultat i bastisjes janë gjetur dhe sekuestruar: një armë e gjatë e modifikuar, një karikator, 25 fishekë, një peshore ngjyrë e zezë, një gëzhhojë, një granatë dore dhe nëntë gram substancë e dyshuar narkotike. Policia njofton se në cilësinë e të dyshuarit është arrestuar një



person, ndaj të cilit është iniciuar rasti penal 'Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve' dhe 'Posedim i substancave narkotike'. Me aktvendim të prokurorit të dyshuarit i është caktuar masa e ndalimit policor prej 48 orëve. Hetimet lidhur me rastin po vazhdojnë.

## Romani dokumentar "Revolta e Sizifit" i Bardhyl Mahmuti do të përurohet më 17 prill në Drenas, më 18 prill në Prishtinë

PRISHTINË, 8 PRILL - Me rastin e 15 Janarit, Ditës së Përkujtimit të Viktimave të Krimit të Gjenocidit që ka kryer Serbia ndaj shqiptarëve në Kosovë, Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" vendosi që për 27-vjetorin e përkujtimit të

viktimave të gjenocidit në fshatin Poklek i Vjetër, ta botojë romanin dokumentar "Revolta e Syzifit" të autorit Bardhyl Mahmuti.

Romani i kushtohet njërit nga krimet më të tmerrshme të zbatimit të gjenocidit gjatë luftës

së viteve 1998-1999, që forcat e armatosura serbe kanë kryer më 17 prillit 1999 në Poklek të Vjetër të komunës së Drenasit.

Përrurimi i këtij romani do të bëhet më 17 prill 2026 në Drenas, ndërkajq më 18 prill në Prishtinë.



## Komisioni për Legjislacion të martën dhe të mërkurën interviston kandidatët për anëtarë të KGJK-së

PRISHTINË, 8 PRILL - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka njoftuar se të martën dhe të mërkurën e javës së ardhshme do të intervistohen në Komisionin

për Legjislacion 23 kandidatë për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. "Sot, Komisioni për Legjislacion, pas shqyrtimit të aplikimeve, ka caktuar intervistimin e kandidatëve

për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të martën dhe të mërkurën do të intervistohen gjithsej 23 kandidatë. Ky proces intervistimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për

rendin dhe ligjin në Kosovë, pasi bëhet fjalë për një institucion shumë serioz dhe me rol kyç në garantimin e sundimit të ligjit në vend", ka shkruar Tahiri në "Facebook".



## AIP PARAQET RAPORTIN 2025 NË KUVEND: MBI 1 MIJË ANKESA DHE 367 INSPEKTIVE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 PRILL - Komisionarja e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dermaku, ka paraqitur para Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes raportin e punës së institucionit për vitin 2025, duke theksuar angazhimin në mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike.

Sipas njoftimit, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka ushtruar fushëveprimtarinë e saj në mënyrë objektive dhe profesionale, në trajtimin e ankesave të adresuara, ofrimin e këshillave dhe opinioneve për institucionet publike, private, qytetarëve dhe grupe të tjera të interesit.

Gjatë vitit 2025 AIP ka pranuar gjithsej 1 085 ankesa nga institucione, organizata, media dhe qytetarë. Në fushën e qasjes në dokumente publike janë trajtuar 927 ankesa, ndërsa "832 ankesa kanë përfunduar me vendime administrative, ndërsa 175 ankesa janë bartur për vitin 2026".

Ndërkaq për mbrojtjen e të

dhënave personale, Agjencia ka pranuar 158 ankesa, ku "139 ankesa kanë përfunduar me vendime administrative, ndërsa nëntëmbëdhjetë (19) ankesa janë bartur për vitin 2026".

Në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, AIP ka realizuar 367 inspektive, prej të cilave 226 sipas detyrës zyrtare dhe 141 bazuar në ankesa.

Agjencia ka theksuar përpjekjet për përafrim me standardet evropiane, duke bërë të ditur se "ka vazhduar veprimet për finalizimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Institucionet e Zbatimit të Ligjit, në përputhje me Direktivën (BE) 2016/680".

Në aspektin e këshillimit janë ofruar 58 këshilla ligjore për sektorin publik, privat dhe qytetarët, ndërsa aktivitetet ndërgjegjësuese kanë qenë të shumta. "Gjatë periudhës janar - dhjetor 2025, janë realizuar mbi 80 aktivitete informuese dhe janë trajtuar mbi 807 pjesëmarrës", thuhet në njoftim.

Po ashtu, Agjencia ka finalizuar katër udhëzues për mbrojtjen e



të dhënave personale, përfshirë privatësinë në internet dhe sektorin shëndetësor, si dhe ka ndërmarrë hapa drejt digjitalizimit përmes lansimit të sistemit CMS për menaxhimin e rasteve.

Në planin ndërkombëtar AIP ka

realizuar mbi 20 aktivitete dhe ka marrë pjesë aktive në mekanizma evropiane, përfshirë European Data Protection Board.

Sipas raportit të Komisioni Evropian për vitin 2024, "Agjencia për Informim dhe Privatësi ka

punuar në mënyrë të pavarur dhe efikase", ndërsa legjislacioni në këtë fushë është në përputhje me standardet evropiane.

Raporti vjetor për vitin 2025 pritet të shqyrtohet dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës.



## 18 VJET NGA NGRITJA E AMBASADËS SË SHBA-së NË PRISHTINË

PRISHTINË, 8 PRILL - Më 8 prill 2008 statusi i Misionit të Shteteve të Bashkuara në Prishtinë u ndryshua zyrtarisht nga një "Zyrë e ShBA-së" në "Ambasadën e ShBA-ve në Prishtinë", pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Kosovës. Në njoftimin e Ambasadës thuhet se: "Me Kosovën

formalisht si shtet i pavarur dhe marrëdhëniet diplomatike të vendosura, hapi tjetër ishte të reflektonte kjo marrëdhënie në praninë tonë diplomatike. Më 8 prill 2008, statusi i Misionit të ShBA-së në Prishtinë u ndryshua zyrtarisht dhe titulli i misionit u bë Ambasadë e ShBA-së në Prishtinë".

Ky ndryshim erdhi pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me ShBA-në më 18 shkurt 2008.

Ambasada përkujton këtë moment historik si pjesë e udhëtimit të Kosovës drejt lirisë dhe forcimit të marrëdhënieve ndërkombëtare.

## Përcillet për votim në Kuvend Projektligji për Maturën Shtetërore

PRISHTINË, 8 PRILL - Nën udhëheqjen e kryetares Arjeta Fejza është mbajtur mbledhja e radhës e Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në të cilën është shqyrtuar dhe miratuar Plani i Punës së Komisionit për sesionin pranveror 2026. Në këtë mbledhje mori pjesë edhe zëvendësministri i

Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Përparim Kryeziu, i cili paraqiti ekspozenë për Projektligjin për Maturën Shtetërore. Në paraqitjen e tij, zëvendësministri Kryeziu deklaroi se përmes këtij projektligji synohet një standard i ri i meritokracisë në sistemin arsimor, duke e

konsoliduar Provimin e Maturës Shtetërore si mekanizëm i besueshëm dhe të drejtë. Duke e potencuar rëndësinë e madhe të këtij projektligji, ai ftoi deputetët ta mbështesin atë. Pas diskutimeve, Komisioni e përkrahu projektligjin, duke rekomanduar miratimin e tij në parim.



## Agon Dobruna emërohet zëvendësministër i parë në Ministrinë e Punës, Familjes dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare

PRISHTINË, 8 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Agon Dobrunën në pozitën e zëvendësministrit të parë në Ministrinë e Punës,

Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare. Sipas njoftimit zyrtar, kryeministri Kurti e uroi Dobrunën për detyrën e re dhe i dëshiroi suksese në

përbushjen e përgjegjësi të reja. Emërimi i tij vjen si pjesë e angazhimit të qeverisë për fuqizimin e punës së

Ministrisë dhe për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm në fushat e punës, familjes dhe vlerave të luftës çlirimtare.



## NDALOHEN PUNONJËS TË POSTËS SË SERBISË NË VERI TË KOSOVËS PËR 'SHPËRNDARJE TË PALIGJSHME' TË DËRGESAVE

MITROVICË, 8 PRILL - Policia e Kosovës ka ndaluar dy persona në Mitrovicën e Veriut, pas dyshimit se, si punonjës të Postës së Serbisë, kanë shpërndarë në mënyrë "të paligjshme" dërgesa postare. Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha për Radion Evropa e Lirë se këta persona janë ndaluar pas një njoftimi se po shpërndanin letra. "Morëm informacion se kishin dërgesa postare me vete, kryesisht bëhej fjalë për vendime nga gjykatat [e Serbisë]. Kjo është e paligjshme për Kosovën, letrat gjyqësore duhet të arrijnë përmes Ministrisë së Drejtësisë", tha Elshani. Ai shtoi se të ndaluarit janë liruar pas marrjes në pyetje dhe se me këtë rast tani po merret Departamenti për Krime



Ekonomike.

Radio Evropa e Lirë pyeti Postën e Serbisë nëse ka vazhduar të funksionojë në Kosovë edhe pasi autoritetet e vendit e kanë mbyllur. "Është fakt i njohur mirë se Posta e Serbisë vepron në Kosovë dhe Metohi", thanë shkurtimisht në

përgjigje.

Po ashtu, Radio Evropa e Lirë mëson nga burimet brenda Postës së Serbisë se punonjësit e saj në Kosovë kanë vazhduar të punojnë pjesërisht në terren edhe pas mbylljes së institucioneve. Institucionet e Serbisë në

Kosovë konsiderohen nga autoritetet e Kosovës si paralele dhe të paligjshme, ndërsa mbyllja e tyre ka nisur në fillim të vitit 2024, pavarësisht kritikave të bashkësisë ndërkombëtare se fillimisht duhej të gjendeshin alternative për ofrimin e shërbimeve për qytetarët, të cilët kryesisht vijnë nga radhët e komunitetit serb. Për shembull, serbët nga Kosova marrin të ardhura të ndryshme nga buxheti i Serbisë, disa prej të cilave u janë paguar në sportelet e Postës së Serbisë, si shtesat për fëmijë ose për lehonat, pensionet, ndihma sociale dhe të ngjashme. Radio Evropa e Lirë në fillim të vitit 2025 ka publikuar edhe rrëfimin e një punonjësi në një nga institucionet e Serbisë, i cili ka deklaruar se disa ditë në javë

punon edhe nga shtëpia, nga Kosova.

Përveç Postës së Serbisë, gjatë dy vjetëve të fundit janë mbyllur edhe Banka Postare e Kursimeve, Banka Kombëtare e Serbisë, drejtoritë e Fondit për Sigurime Pensionale dhe Invalidore, qendrat për punë sociale, ndërmarrjet komunale publike, organet e përkohshme komunale dhe shumë institucione të tjera.

Beogradi zyrtar refuzon t'i mbyllë këto institucione, dhe shumicën e ka zhvendosur në zonat kufitare brenda territorit të Serbisë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar më parë se me mbylljen e institucioneve serbe në Kosovë rreth 5.800 persona kanë mbetur pa vendet e tyre të punës, por se ata do të vazhdojnë të marrin pagat.

## ISA MUSTAFA PROMOVON LIBRIN PËR KONVERGJENCËN EKONOMIKE TË KOSOVËS ME BE-në

PRISHTINË, 9 PRILL - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka promovuar librin më të ri "Konvergenca ekonomike e Kosovës me Bashkimin Evropian", një botim që trajton në mënyrë të thelluar sfidat dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit në raport me standardet evropiane. Në këtë libër Mustafa sjell një analizë të gjerë mbi procesin e afrimit të ekonomisë së Kosovës me Bashkimin Evropian. Mustafa foli për motivin për ta trajtuar çështjen e ekonomisë në këtë libër. "Desha t'ju them se motivi kryesor imi për t'u marrë me këtë çështje nuk ka qenë vetëm motivi akademik, por ka qenë edhe një ndjenjë përgjegjësie, edhe mendimet e vazhdueshme për përsëritjen e historisë në zhvillimin tonë ekonomik, për atë që quhet sindroma e të qenit i fundit në një sistem më pak të zhvilluar dhe në një sistem tjetër të fundit në zhvillim. Prandaj,



pikërisht për këtë dilemë, e kam parë të domosdoshme të përkushtohem në analizën e

konvergjencës ekonomike të Kosovës jo vetëm nga pikëpamja ekonomike, por edhe nga

pikëpamja e reflektimit të shoqërisë sonë mbi rrugën që ne kemi zgjedhur si shoqëri në

zhvillimin ekonomik dhe lidhur me masat që duhet të ndërmerrem që të dalim nga ky cikël në të cilin tani ndodhemi", tha ai.

Kryetarja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Justina Shiroka-Pula, tha se akademik Mustafa, si njohës i mirë i proceseve dhe rrjedhave ekonomike, edhe në këtë libër ka një qasje shkencore, moderne dhe profesioniste, të bazuar në burimet dhe relevancën e kohës së kësaj fushe.

"Në këtë botim, 'Konvergenca e ekonomisë së Kosovës me Bashkimin Evropian' trajtohet si një synim thelbësor për arritjen e një zhvillimi ekonomik që siguron standarde të larta jetësore për qytetarët dhe prosperitetin e vendit", tha ajo. Kurse akademik Besnik Krasniqi tha se libri trajton tema që janë të rëndësishme në fushën e ekonomisë.

## Artan Demolli caktohet ushtrues detyre në pozitën e sekretarit të përgjithshëm të MINTI-t

PRISHTINË, 8 PRILL - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) e ka caktuar Artan Demollin ushtrues detyre në pozitën e sekretarit të përgjithshëm të MINTI-t. Vendimi është

nënshkruar nga ministrja Kusari-Lila dhe ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit. Sipas vendimit, Artan Demolli do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit të përgjithshëm në përputhje me

legjislacionin në fuqi. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet e mëhershme lidhur me ushtrimin e kësaj detyre, pozite e cila deri më tani është ushtruar nga Agim Xhuraj.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit mbetet e përkushtuar për vazhdimin e funksionimit institucional dhe përbushjen e obligimeve në kuadër të mandatit të saj.



# KËRCËNIME, INFO, PËRBALLJA ME VANCE. DITA E DONALD TRUMP ME ORËN NË DORË

*Manjati i fiksuar në Shtëpinë e Bardhë, mes Fox dhe klipeve në rrjetet sociale*



Programi i ditës, i shpërndarë dje nga Shtëpia e Bardhë për ditën e ultimatimit, parashikonte në mëngjes “executive time” (takime, telefonata, ndoshta edhe një sy gjumë: teknikisht do të thotë se nuk publikohen detaje). Gjatë kësaj “executive time”, Trump foli me JD Vance, i dërguar në Budapest përpara votimit që e sheh mikun e tij Viktor Orbán në vështirësi.

Më pas, drekë; në orën 16:00 (22:00 në Itali), një “policy meeting” i mbyllur për shtypin, ku u mor vendimi përfundimtar se si do të veprimej në skadimin e ultimatimit. Vendimi u mor pak më shumë se një orë para afatit: një armëpushim dyjavor, i shpallur si zakonisht përmes Truth Social. Në orën 19:00 në Washington (01:00 në Shqipëri), darkë me ambasadorin amerikan në Indi, një besnik i

tij, Sergio Gor (i lindur në Uzbekistan me emrin Sergey Gorokhovsky).

Dita e pritjes u karakterizua nga tensioni dhe nga ripërsëritjet e vazhdueshme në rrjetet sociale dhe televizion të dialogëve të Trumpit me fëmijët gjatë festës së Pashkës në Shtëpinë e Bardhë. Dialogë që, siç Trump e dinte shumë mirë, duke qenë se kishte kërcënuar Iranin në transmetim global përkrah një personi të veshur si lepur gjigant, pushtuan jo vetëm televizionet, por edhe rrjetet sociale, sidomos TikTok.

Interpretimet ishin të ndara politikisht: nga e majta, si prova e “çmendurisë” së një presidenti-monark; nga e djathta, si dëshmi e simpatinë së “gjyshit Donald” përballë brezit të ri (më saktë, fëmijëve). «Mund t’ju firmos autografe, fëmijë. Dhe pastaj sonte mund

ta shisni për 25 mijë dollarë në eBay!... Mbesa ime Caroline është e vetmja që nuk e do autografin tim... duket se Caroline ka zero interes për autografin tim. Do ta firmos vizatimin tënd dhe do them se e kam bërë unë. Shikoni, e kam bërë unë! Shikoni të gjithë çfarë kam bërë. Biden kishte një stilolaps automatik që e ndiqte, ai nuk firmoste asgjë vetë, nuk ishte në gjendje të firmoste... kështu që e ndiqnin me një makinë shumë të madhe. E dini si quhej? Autopen! Jo shumë bukur, apo jo? Po Kamala Harris? Kishte një koeficient të ulët inteligjence!».

Përtej politikës, bie në sy që një 77-vjeçar me 11 nipër e mbesa u drejtohet fëmijëve të vegjël sikur të ishin të rritur.

24 orët e fundit përpara armëpushimit, presidenti i kaloi në Shtëpinë e Bardhë, ku

televizorët janë gjithmonë të sintonizuar në Fox News, kanal që Trump e ndjek vazhdimisht dhe nga i cili shpesh ripublikon klipet e preferuara në rrjetet sociale.

Ai nuk mund të mos ketë vlerësuar transmetimin e mëngjesit ku ish-avokati i tij personal, Todd Blanche, debutoi si ministër i përkohshëm i Drejtësisë në një konferencë për shtyp të transmetuar live. Ai sulmoi mediat («Për katër vite, pa thënë asgjë, lejuat që ky departament të kthehej në armë kundër Donald Trump») dhe më pas njoftoi hetime të reja mbi mashtrimet e dyshuara në programet e mirëqenies sociale, veçanërisht për kujdesin ndaj fëmijëve (hetime që aktualisht prekin kryesisht shtete me shumicë demokrate). Pragu i kësaj dite ishte një lloj

“numërimi mbrapsht”-i tipik i spektaklit, një element që Trump, ish-yll i “The Apprentice”, e njez shumë mirë. Dita nisi me një postim apokaliptik në rrjetin e tij social, ku kërcënonte zhdukjen e qytetërimit iranian.

Tensioni para një sulmi të mundshëm është një element thelbësor i spektaklit që Trump e njez mirë: ai i wrestling-ut, me fyerjet, armiqtësinë mes kundërshtarëve që shahen dhe përballen me njëri-tjetrin. Është një element që gjendet edhe në kulturën rap, një botë që e ndjek Trump me interes (mjafton të përmenden Snoop Dogg dhe 50 Cent), dhe që e njez si të vetën përdorimin e nofkave fyese për kundërshtarët dhe mburrjen me përballjet e tij ligjore. / Corriere della Sera – Bota.al

# MIGRIMET DHE SHKATËRRIMI DEMOGRAFIK I BIHORIT (1912-1990)



Nga: Ismet AZIZI

Proceset demografike në rajonin e Bihorit gjatë shekullit XX nuk mund të kuptohen jashtë kontekstit të transformimeve politike dhe ideologjike që përfshinë Ballkanin pas rënies së Perandorisë Osmane. Në këtë hapësirë, migrimet nuk paraqiten si dukuri spontane, por si rezultat i drejtpërdrejtë i politikave shtetërore, dhunës së organizuar dhe presionit të vazhdueshëm mbi popullsinë myslimane dhe shqiptare. Në këtë kuadër, studimi i historianit boshnjak Izet Shabotiq mbi rajonin e Bihorit përbën një nga analizat më të rëndësishme për të kuptuar procesin e asaj që ai e quan "shkatërrim demografik" i kësaj zone, një proces që fillon me Luftërat Ballkanike (1912-1913) dhe vazhdon në forma të ndryshme deri në fund të shekullit XX. Pushtimi i Bihorit dhe i Sanxhakut nga ushtritë serbe dhe malazeze në vitet 1912-1913 shënoi një kthesë të thellë historike. Ky moment përfaqëson jo vetëm një ndryshim administrativ, por fillimin e një politike sistematike të transformimit etnik. Sipas Shabotiqit, menjëherë pas pushtimit u ushtrua dhunë e

drejtpërdrejtë ndaj popullsisë myslimane, u konfiskua prona, u vendos kolonizimi me popullsi sllave.

Këto masa krijuan klimën e frikës që prodhoi valën e parë të muhaxhirëve. Vetëm përmes portit të Tivarit, deri në vitin 1914, u shpërngulën mbi 12 000 myslimanë, ndërsa edhe nga vetë Bihori i Epërm dhjetëra familje u detyruan të largohen.

Ky zhvillim përputhet me dëshmitë e vëzhguesve ndërkombëtarë, si Lav Trocki, i cili raportonte për shkatërrimin sistematik të fshatrave myslimane gjatë avancimit të ushtrive ballkanike.

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, presioni mbi popullsinë myslimane mori karakter institucional. Në kuadër të Mbretërisë SKS (më pas Jugosllavisë), myslimanët trajtoheshin si element i padëshiruar dhe si pengesë për homogenizimin etnik të shtetit. Shabotiqi thekson se propaganda për shpërngulje drejt Turqisë ishte e organizuar dhe e vazhdueshme, ndërsa marrëveshjet shtetërore me Turqinë krijuan bazë ligjore për këtë proces.

Në këtë periudhë, sipas të dhënave të tij, nga Ballkani u shpërngulën midis 348 000 dhe 475 000 myslimanë.

Ky proces përputhet

drejtpërdrejt me projektet ideologjike të kohës, të artikuluar më vonë në mënyrë të qartë nga Vasa Çubriloviqi, i cili propozonte shpërnguljen sistematike të shqiptarëve dhe myslimanëve si zgjidhje për "çështjen kombëtare".

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, dhuna ndaj popullsisë myslimane jo vetëm që nuk u ndal, por u intensifikua.

Në vitin 1919, sipas burimeve të cituara nga Shabotiqi, u vranë mbi 1 300 myslimanë, u shkatërruan 194 fshatra.

Kulmi i kësaj dhune u arrit me masakrën e vitit 1924 në Shahoviq dhe Pavinë Pole, ku u vranë mbi 500 civilë myslimanë. Këto ngjarje krijuan trauma kolektive, nxitën vetëmbrojtjen lokale (komitë) dhe përshpejtuan procesin e shpërnguljes.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, popullsia myslimane e Bihorit u përball me rrezik ekzistencial nga formacionet çetnike, të cilat kishin për objektiv krijimin e një hapësire etnikisht të pastër.

Në këtë kontekst, formimi i Milicisë Myslimane në vitin 1941, nën drejtimin e Osman ef. Rastoderit, përfaqëson një reagim të organizuar mbrojtës.

Shabotiqi thekson se sulmet çetnike ishin të vazhdueshme dhe të orientuara drejt spastrimit etnik të zonës.

Kjo analizë përforcon tezën se strukturat lokale të mbrojtjes nuk ishin thjesht formacione kolaboracioniste, por përgjigje ndaj një kërcënimi të drejtpërdrejtë për mbijetesë.

Pas vitit 1945, regjimi komunist vendosi kontroll të fortë politik dhe ideologjik mbi popullsinë.

Në këtë periudhë u eliminuan figura lokale me ndikim, u kufizua jeta fetare, u ushtrua presion për integrim ideologjik. Megjithatë dhuna e drejtpërdrejtë u reduktua, presioni strukturor vazhdoi të prodhonte migrimet.

Një moment kyç në destruktimin demografik të Bihorit ishte marrëveshja e vitit 1953 ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë. Sipas Shabotiqit, në periudhën 1953-1961, nga Jugosllavia komuniste u shpërngulën 291 298 persona drejt Turqisë.

Ky proces u mbështet nga aparati shtetëror, shpesh kërkonte deklaram si "turk" për të mundësuar emigrimin.

Pas viteve '70 të shekullit XX, migrimet vazhduan, por me drejtime të reja: drejt Bosnjës, Kosovës dhe Evropës Perëndimore - drejt diasporës ekonomike.

Si pasojë, u krijua një diasporë e gjerë bihorase, ndërsa vetë rajoni pësoi zbrazje të vazhdueshme. Një nga kontributet më të


rëndësishme të Shabotiqit është analiza statistikore e stagnimit demografik.

Ai tregon se në vitin 1931 Bihori kishte rreth 5 000 banorë, në vitin 2003 vetëm 5 702 banorë. Ky stagnim për më shumë se shtatë dekada përbën devijim drastik nga zhvillimi natyror, dëshmon për një proces të qëllimshëm të dobësimit demografik.

Sipas tij, sot rreth dy të tretat e popullsisë me origjinë nga Bihori jetojnë jashtë këtij rajoni.

Analiza e migrimetve nga Bihori, e mbështetur në studimin e Izet Shabotiqit, dëshmon se kemi të bëjmë me një proces të vazhdueshëm dhe të strukturuar të transformimit demografik. Nga dhuna e drejtpërdrejtë e viteve 1912-1913, te politikën shtetërore të Mbretërisë Jugosllave, terrori ndërmjet dy luftërave, kërcënimi ekzistencial gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe marrëveshjet e pasluftës për shpërngulje, krijohet një vijë e qartë historike: Migrimet nuk ishin zgjedhje - ato ishin pasojë e presionit sistematik.

Në këtë kuptim, rasti i Bihorit mund të trajtohet si një model i shkatërrimit të qëllimshëm demografik, që lidhet drejtpërdrejt me projektet politike për transformimin etnik të hapësirës së Sanxhakut dhe më gjerë. /Telegrafi/



## Antonio Conte mund të rikthehet te Kombëtarja e Italisë

**ROMË, 8 PRILL** - Trajneri i Napoli, Antonio Conte, ka lënë të hapur mundësinë e rikthimit në krye të Kombëtares së Italisë. Pas fitores 1-0 ndaj AC Milan, që e ka ngjitur Napolin në vendin e dytë në Serinë A, Conte ka komentuar spekulimet rreth së ardhmes së tij në konferencë për medie. "Është normale që

emri im të përmendet për kombëtaren italiane. Nëse do të isha president i federatës, edhe unë do ta merrja në konsideratë emrin tim", ka thënë ai.

Trajneri italian ka kujtuar edhe përvojën e tij të mëparshme në krye të "Azzurrëve", ku ka shërbyer nga viti 2014 deri në

2016. Megjithatë, ai ka thënë se gjithçka do të varet nga situata e tij aktuale kontraktuale. "E di si funksionon kombëtarja, por kam një kontratë. Në fund të sezonit do të takohem me presidentin dhe pastaj do të shohim", ka thënë Conte.

Nga ana tjetër, presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis,

nuk e ka përjashtuar mundësinë e largimit të trajnerit. "Nëse Conte do të më kërkonte ta liroja për ta marrë drejtimin e kombëtares, mendoj se do të pranoja", ka thënë ai.

Posti i trajnerit të Italisë është vakant pas largimit të Gennaro Gattuso më 3 prill, ndërsa



përvoja dhe forma e mirë e Contes me Napolin e bëjnë atë një nga kandidatët kryesorë për këtë post.

## MINISTRIA E SPORTIT DHE FEDERATAT NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË VLERË PREJ 6.5 MILIONË EUROSH

**PRISHTINË, 8 PRILL** - Ministria e Sportit dhe Rinisë ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me 39 federata sportive për vitin 2026. Ky aktivitet ka shënuar formalizimin e mbështetjes institucionale për zhvillimin e sportit në vend. Ministri Blerim Gashani ka theksuar se federatat sportive janë partnerë kyç në këtë rrugëtim dhe bartin rol të pazëvendësueshëm në



zhvillimin e sportit. Ai ka nënvizuar se Ministria do të vazhdojë të jetë në përkrahje të tyre, duke kërkuar standarde të larta profesionalizmi, përkushtimi dhe arritje konkrete në secilin sport. Sipas tij, përmes këtyre memorandumeve po konkretizohet mbështetja financiare në vlerë prej mbi 6.5 milionë eurosh në bazë të kategorizimeve të sporteve. Ai ka shtuar se kjo mbështetje synon

ta forcojë qeverisjen në sport, ta rrisë performancën e sportistëve dhe të promovojë një shoqëri më aktive dhe të shëndetshme. Gashani ka theksuar gjithashtu rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies, duke vlerësuar se besimi i qytetarëve ndërtohet përmes punës së ndershme dhe raportimit të hapur, si standard i përbashkët për të gjitha federatat.

## FFK-ja VAZHDON TRADITËN E ORGANIZIMIT TË KAMPEVE SELEKSIONUESE PËR TALENTËT NË DIASPORË

**GRUNBERG, 8 SHKURT** - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) është duke vazhduar me përkushtim traditën e organizimit të kampeve seleksionuese për talentët në diasporë. Kampi i radhës është duke u zhvilluar në Grunberg, afër Frankfurtit, në bashkëpunim me Federatën e Futbollit Shqiptar në Gjermani. FFK-ja ka njoftuar se interesimi për këtë kamp ka qenë jashtëzakonisht i madh, me një numër shumë të lartë aplikuesish. "Megjithatë, për t'i dhënë mundësi sa më shumë talenteve që të shfaqin potencialin e tyre, FFK do të organizojë shumë shpejt gjatë verës edhe një kamp tjetër

seleksionues në Kosovë. Gjatë dy ditëve të para, në këtë kamp kanë marrë pjesë 23 vajza të grupmoshave 2009, 2010 dhe 2011. Ato kanë treguar përkushtim të madh dhe dëshirë të jashtëzakonshme për të përfaqësuar Kosovën, duke reflektuar seriozitetin në çdo segment të punës. Programi ka përfshirë një seancë stërvitore dhe një ndeshje testuese, ku janë evidentuar disa talente premtuese që pritet t'u shtohen listave të ekipeve kombëtare të vajzave në të ardhmen", ka njoftuar FFK-ja. Më tutje, FFK-ja ka njoftuar se aktivitetet kanë vazhduar edhe me fillimin e grumbullimit për



gjeneratën 2011 të djemve, ku 25 futbollistë kanë zhvilluar seancën e parë stërvitore. "Për këtë grup është paraparë që

nesër të zhvillohet edhe një ndeshje kontrolluese, që do të shërbejë si mundësi shtesë për vlerësimin e tyre nga ana e

trajnerëve të ekipeve kombëtare të grupmoshave. Kampi do të vijojë nesër pasdite me gjeneratën 2012, ku do të marrin pjesë 24 futbollistë. Pjesëmarrësit e këtij kampi vijnë nga klube të ndryshme evropiane, kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, por ka talente edhe nga Austria dhe shtetet skandinave, duke dëshmuar edhe një herë potencialin e madh që ka diaspora. Ky kamp seleksionues është një tjetër hap i rëndësishëm i FFK-së në identifikimin e hershëm të talenteve, por edhe në forcimin e lidhjes së tyre me fanellën dardane", ka njoftuar FFK-ja.

## Ndërron jetë trajneri legjendar rumun Mircea Lucescu

**BUKURESHT, 8 PRILL** - Trajneri legjendar rumun Mircea Lucescu ka vdekur në moshën 80-vjeçare. Njoftimi për vdekjen e Lucescut është bërë me dije nga Spitali Universitar i Bukureshtit. "Mircea Lucescu ishte një nga trajnerët dhe lojtarët më të suksesshëm rumunë të futbollit, i pari që kualifikoi ekipin kombëtar rumun për një Kampionat Evropian, në vitin 1984. Breza të tëra rumunësh u rritën me imazhin e tij në zemrat e tyre, si

një simbol kombëtar. Zoti ia prehtë shpirtin", ka njoftuar Spitali Universitar i Bukureshtit. Lucescu pak ditë më parë ishte në stolin e ekipit të Rumanisë në ndeshjen gjysmëfinale të "play-off"-it kualifikues për Kupën e Botës 2026 kundër Turqisë. Rumania e kishte humbur 1:0 ndeshjen. Pas kthimit në Rumania, gjendja shëndetësore e Lucescut ishte përkeqësuar. Ai kishte humbur ndjenjat gjatë stërvitjes për ndeshjen miqësore kundër

Slovakisë më 31 mars. Ai ishte në gjendje kome. Më 2 prill, Federata e Futbollit e Rumanisë kishte njoftuar se kishte ndarë rrugët me përzgjedhësin ikonik. Lucescu në krye të Rumanisë ishte rikthyer në vitin 2024. Lucescu e ka drejtuar Rumaninë si selektor edhe më herët. Ai ka punuar te Rumania nga viti 1981 e deri në 1986. Lucescu është prej trajnerëve më të mëdhenj që ka ardhur në stadiumin në Prishtinë. Ka drejtuar Rumaninë në dy

ndeshjet kundër Kosovës në Ligën C të Ligës së Kombeve. Rumania i kishte fituar dy ndeshjet. Të parën në Prishtinë më 6 shtator, Rumania e pati fituar 3:0, ndërsa me rezultat zyrtar 3:0 e kishte fituar edhe ndeshjen në Bukuresht më 15 nëntor. Pas disa përplasjeve të lojtarëve në fushë, një grup i tifozëve rumunë nisën thirrjet "Serbia, Serbia". Lojtarët e Kosovës vendosën të lëshojnë fushën dhe nuk ishin kthyer edhe kur këtë ua kishte kërkuar



gyqtari i ndeshjes. Ndeshja ishte ndërprerë në minutat e fundit kur rezultati ishte 0:0. Menjëherë më 20 nëntor 2024, UEFA e kishte regjistruar ndeshjen me rezultat zyrtar 3:0 në të mirë të Rumanisë. Edhe CAS-i në maj të vitit të kaluar kishte vendosur njëjtë si UEFA.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

